



Bazel, 22 prill

Në kuadër të angazhimeve të vazhdueshme në sferën e integrimit e të kulturës Qendra për Arsimitin dhe Këshillimin e Mërgimtarëve (ABSM) në Basel, që për afro një decenie udhëhiqet me shumë sukses nga drejtori, Skender Nikoliqi, të premtën më 20 maj, organizoi një takim tematik me shumë interes në temën: Edukimi dhe integrimi ndërkulturor e që ndërlidhej kryesisht me shkollimin, edukimin dhe integrimin e fëmijve shqiptar në këtë kanton. Me këtë rast në praninë e një numri myafirësh nga lëmi i arsimit e shkencës, diplomacisë e kulturës, dhe të një "numri artdashësish shqiptarë" e zviceranë, u bë edhe promovimi i librit "Fëmijët dhe të rinjtë shqipfolës në Zvicër", të docentit të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Cyrih, Dr. Basli Schader, një shkencëtarë të shquar zviceran që i ka kushtuar shumë angazhim dhe vëmendje sidomos arsimimit të shqiptarëve në mësimin plotësues këtu në Zvicër, përqë ka mbrojtur një temë doktoraturë n'gjuhen shqipe në Tiranë. Me këtë rast edhe rrith temës së lartpërmendorur

## ZVICRA VEND I SHANSEVE DHE I VLERAVE DEMOKRATIKE KU MUND TË PËRFITOJË EDHE KOMUNITETI I MADH SHQIPTAR

*Në praninë e ambasadorit të Shqipërisë, Mehmet Elezit, sekretarit të Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë së Kosovës Dr. Fehmi Ismailit u bë promovimi i librit të Dr. Basli Schader, "Fëmijët dhe të rinjtë shqipfolës në Zvicër" si dhe u zhvillua një debat temën :Edukimi dhe integrimi ndërkulturor, e që ndërlidhej me shkollimin dhe edukimin e fëmijëve shqiptar në këtë kanton.- Manifestimi u përcoll edhe me disa pikave artistike*

edhe rrith promovimit të librit u zhvillua një debat i gjërë e konstruktiv.

Pas realizimit të disa pikave muzikore nga muzikant i njohur zviceran, Albert Roman, çelit, takimin e shpalli të hapur magjistri shkencave juridike, Nazmi Jakurti, i cili në rolin e mediatorit, që në fillim përshtëndetë praninë e ambasadorit të Shqipërisë, z. Mehmet Elezi, Dr. Fehmi Ismailit, sekretar të përhershëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë së Kosovës (MASHT), si dhe Nuhi Gashit, përgjegjës pranë kësaj ministrie për çështjen e shkolimit në diasporë të Prof. Dr. Basil Schader, studiuves i shquar edhe në fushën arsimit shqiptarë në mërgatë. Në këtë takim tematik merrnin pjesë edhe kryeredaktori i të përditshmes sonë "Bota sot", Skender Buçpapaj dhe kulministja Elida Buçpapaj si dhe përfaqësues të institucioneve të arsimit zviceran dhe të mjeteve të informimit.

Pas një fjale të Prof. Dr. Basil Schader, për librin e tij dhe një përshtëndetjeje që e bëri në emër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë së Kosovës, sekretari



i saj përmenant, Dr. Fehmi Ismailit, u lexua një tekst tejet përbajturi i deputetit të parlamentit zviceran dhe mikut të shqar të shqiptarëve z. Ueli Leuenbergerit, lidhur me pozitën e shqiptarëve në Zvicër.

#### **Krahasuar me madhësinë e Zvicrës, këtu jeton komuniteti më i madh shqiptar në botë**

Më pastaj udhëheqësi tryezës Nazmi Jakurti, në pyetjen drejtuar ambasadorit të Shqipërisë dhe studiuesit e publicistit, z. Mehmet Elezi, lidhur me atë se si e vlerëson ai pozitën e komunitetit shqiptar në Zvicër, mori këtë përgjigje:

- Mund t'u them se Zvicra është vend i shansave të mëdha. Është një vend i vlerave demokratike, i vlerave njerëzore dhe që njëherazi ato vlera, si dhe mirëqenien dhe pasurinë e saj, nuk i mban me xhelozit vetëm përvete, por i shpërndan edhe përf t'gjithë t'jerët me përpjot bujari dhe humanizëm. Ndaj edhe nuk është e rastit që profesor Schadri përruron sot librin e tij të dytë të tij të botuar në gjuhën shqipe rrathë ndërlid-



**Prof. Dr. Basil Schahder edhe me një libër të çmueshëm shkencor-arsimor kushtur fëmijëve shqiptar në Zvicër**



**Edhe qifti bashkëshortor Arjeta e Hil Thaqi me këngë të vjetra qytetare krijuan një ambient melankolik në sallë**



**Mysafirë nga Kosova, Shqipëria e diaspora pjesëmarrës në këtë takim bisedimi e promovimi**

dhe të shkollimit të fëmijëve tanë në Evropë dhe përgjithësisht në botë. Angazhimi i deritashëm as për së afërmë nuk është i mjaf-tueshëm, sepse Kosova a pasluftës është në një situatë mjaft të rëndë për shkak të shtrirjes së madhe gjeografike të bashkatdhëtarëve tanë në vendet e ndryshme të botes. Por edhe për shkak të statusit të deritashëm të Kosovës, e cila nuk ka pasur mundësi që

në mënyrë institucionale t'i qaset problemit të shkollimit në mërgatë.

Tash jemi në fazën e hartimit të programeve, porse ne edhe në këtë fazë nuk mund të bëjmë nuk mund të bëjmë programe sipas vendit. Besojmë se me zgjidhjen e statusit të Kosovës krijohen mundësi përmarrëveshje ndërshtetëre, ndaj edhe një marrëveshje të tillë shpresojmë se do ta arrijmë edhe

me organet përkatëse arsimore të Zvicrës, sepse përkundër përpjekjeve të deritashme siç po shihet edhe më tej nuk është i kënaqshëm numri i fëmijëve shqiptarë që ndjekin mësimin plotësues në gjuhën amtare. Pra për integrim dhe arsimim të vërtetë këtu e kudo që jetojnë shqiptarët duhet të bëhet një qasje profesionale dhe një angazhim serioz si nga mësimdhënësit ashtu edhe institucionet përkatëse.

Në bisedën që u zhvillua lidhur me çështjen e shkollimit dhe të integrimit të fëmijëve tanë këtu në Zvicër, u kyçën në bisedë edhe Sylvia Bollhalder, konkrektore e shkollave orientuese të Bazelit, Julia Morais deleguar e kantonit të Basel-Stadtit për çështje të migrimit dhe integrimit si dhe Nexhat Maloku, mësimdhënës i Shkollës Shqipe të mësimit plotësues shqip në Cyrih, koordinator i kursit për Gjuhën dhe Kulturën e origjinës. Tërë këtij takimi kontribut të veçantë i dha edhe përkthyesi i dalluar nga dy gjuhët, Xhafer Ymeri. Ndërsa që freskinë e kësaj mbrëmje e përbushën edhe disa pikë muzikore në realizim të denjë me piano e tenor nga qifti Arjeta dhe Hil Thaqi si dhe disa valle të bukura shqiptare në realizim të Shkollës Shqiptare të Vallëzimit në Zvicër "Shota", në koreografi të Agron Bajramit.

**Teksti e fotot: Rexhep Rifiati**



**Mysafirë nga të gjitha vise shqiptare në takimin e Bazelit, në krye me ambasadorin shqiptar, Mehmet Elezi**

## **EDHE FËMIJËT E PASTRUESVE - DOKTORË SHKENCASH**

Që në fillim të fjalës së tij ambasadori i Shqipërisë dhe studiuesit, Mehmet Elezi, përmendi rastin e një takimi siç e Quajti i prej "kurtuazie" me ambasadorin e Greqisë në Zvicër i cili i kishte thënë se 30-40 vit më parë kur kanë ardhur grekët në fillim kanë punuar si pastrues spitalesh dhe se sot po djemtë e disa prej atyre pastruesve kanë arritur tash t'ë bëhen edhe doktorë shkencash, janë të shqar intelektualisht në Zvicër.

Shembullin tjetër se edhe disa nga shqiptarët e rinx që kanë shkelur rrugën e famës e të prosperitetit, ambasadori Elezi i kishte dëgjuar nga goja e presidentes së këtij vendi mik, zonja Calmy-Rey, e cila n'një tubim në Gjenevë duke folur përf t'rinjtë nga Ballkani kishte marrë si shembull tre shqiptarë të rinx: Valon Behramin që me golin e tij famoz e kishte kualifikuar zviceran përf në kampionin botëror, karateistin Fehmi Mahallën që i kishte sjellë Zvicrës titullin e kampionit evropian dhe Driton Kajtzin që me librin "Hënore e Zvicrës" antologji kjo e letërsisë së Zvicrës Franceze.

hjes dyguhësore këtu në Zvicër. Tek vepra e profesor Schadrit, që e kam lexuar me shumë interes, nëse donë t'ë kesh një analizë të vërtetë shkencore faktografike, këtë e gjen tek vepra e e Shadrit ku pasqyrohet inteligjenca dhe mendja zvicerane.

Unë mendoj se përf t'gjithë shqiptarët që janë këtu, në krahasim me popullsinë që ka Zvicra, prej 7-8 milionë banorësh, këtu jeton komuniteti më i madh shqiptar në botë në krahasim me popullsinë. Pra, është një shans i jashtëzakonshëm që u jepet bashkëvëllezërvë tanë, shqiptarëve që janë këtu.

#### **MASHT - në fazën e hartimit të programeve dhe teksteve shkolllore për diasporë**

Dr. Fehmi Ismaili, sekretar i përhershëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë së Kosovës (MASHT), në pyetje se sa dhe si është e kyçur ministri ku punon ai në hartimin e plan-programeve shkolllore si dhe rreth teksteve adekuate shkolllore që kanë të bëjnë me mësimin plotësues shqip në mërgatë.

Ministria jonë po bënë përpjekje të vazhdëshme se si të zbutë problemin e integrimit